



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



---

Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

## **Raport i punës dhe aktiviteteve vjetore të KQZ-së**

**Janar – Dhjetor 2009**

**Prill 2010**

## Hyrje

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ("KQZ") si institucion i pavarur është përgjegjës për organizimin dhe implementimin e zgjedhjeve dhe referendumeve në Kosovë sipas kronizës ligjore në fuqi, ligjit për zgjedhjet e përgjithshme 04/L-073 dhe ligjit për zgjedhjet lokale 04/L-072.

KQZ-ja në pajtim me autorizimet e dhëna me nenit 11.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ka themeluar brenda SKQZ-së, Zyren për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (Zyra). Zyra është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit të partive politike, certifikimin e subjekteve politike që garojnë në cilatdo zgjedhje, akreditimin e vëzhguesve për të vëzhguar zgjedhjet.

Sekretariati i KQZ-së ("SKQZ") si strukturë mbështetëse e KQZ-së, i themeluar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, mbështetë profesionalisht dhe teknikisht KQZ-në në organizimin dhe implementimin e tyre si në nivelin qendror ashtu edhe atë lokal përmes Zyrarëve Komunal të Zgjedhjeve (ZKZ).

KQZ-ja pas rumbullakësimit të kuadrit normativ zgjedhor-miratimit të katërmbëdhjetë (14) Rregullave Zgjedhore të parapara me Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet Lokale, aktivitetin e saj kryesor e ka përqendruar në përgatitjen e Zgjedhjeve për Kuvendet Komunale dhe Kryetarë të Komunave të shpallura nga Presidenti i Republikës së Kosovës për datën 15 nëntor 2009.

## **I. Aktivitetet e KQZ-së gjatë vitit 2009**

Gjatë kësaj periudhe KQZ-ja ka vijuar me implementimin e aktiviteteve dhe projekteve të ndryshme të përcaktuara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në funksion të përgatitjeve të zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit 2009.

### **1. Aktivitetet kryesore të KQZ-së gjatë periudhës njëvjeçare janë si në vijim:**

- **Plani i Punës 2009** - i cili përcakton aktivitetet, projektet, afatet e implementimit të aktiviteteve zgjedhore, procedurat e planifikimit dhe përgjegjësitë dhe mjetet e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve gjatë vitit 2009 (*shih Shtojcën nr. 1*);
- **Plani Operacional i Zgjedhjeve Komunale 2009** – plan i cili parasheh të gjitha përgatitjet e nevojshme për të organizuar zgjedhjet duke përcaktuar gjithashtu të gjitha afatet kohore në përputhshmëri me ligjin dhe rregullat zgjedhore të miratuara nga KQZ-ja. (*shih Shtojcën nr. 2*);
- **Misionet vëzhguese** - KQZ-ja ka marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesve në Zgjedhjet Parlamentare të Shqipërisë të mbajura me 28 qershor 2009, dhe në Zgjedhjet për Parlamentin Europian në Hungari të mbajtura më 7 qershor 2009;
- **Marrëveshje bashkëpunimi** - Ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën e Zyrarëve Zgjedhor të Evropës (ACEEEO) më 8 Maj 2009 e cila marrëveshje zyrtarizon marrëdhëniet e KQZ-së dhe kësaj shoqatë me qëllim

të përfitimi në programet dhe trajnimet e organizuara nga ACEEEO në çështjet lidhur me administrimin zgjedhor.

- **Vendimet e KQZ-së** – gjatë periudhës raportuese, KQZ-ja gjatë mbledhjeve të rregullta të mbajtura ka nxjerrë gjashtëdhjetë e katër (64) vendime. Përmes këtyre vendimeve KQZ-ja ka vendosur për çështjet si: Certifikimin e Subjekteve Politike, Shërbimi i Votuesve/Përpilimi i Listës së Votuesve, Trajnimi, Akreditimi i Vëzhguesve vendor dhe ndërkombëtar, Votimi përmes postës, Votimi i personave me nevoja të veçanta, Operacionet në Terren si dhe Deklarimi Financiar i SP-ve për fushatën parazgjedhore. Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme KQZ-ja ka zbatuar procedurat e zëvendësimeve të këshilltarëve të Kuvendeve Komunale si dhe zëvendësimin të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Gjatë kësaj periudhe KQZ-ja ka marrë pesëdhjetë e katër (54) vendime për zëvendësimin e këshilltarëve komunal, ndërsa në gjashtë (2) kërkesa të Presidentit të Republikës së Kosovës ka rekomanduar emrat e kandidatëve të radhës për zëvendësimin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Vendimet e KQZ-së janë të publikuara në ëbsite-in e KQZ-së: [www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org).

## **II. Organizimi dhe implementimi i Zgjedhjeve për Kuvendet Komunale dhe Kryetarë të Komunave 2009**

Pas shpalljes së datës së Zgjedhjeve Lokale të 15 Nëntorit 2009 nga Presidenti i Kosovës më 16 qershor 2009 Sekretariat i KQZ-së në përputhshmëri me vendimet e KQZ-së ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për të siguruar kushtet për implementimin e zgjedhjeve lokale 2009. Si fillim, Sekretariati i KQZ-së ka draftuar një Plan Operacional me të gjitha aktivitetet e parapara për këto zgjedhje i cili më pas është miratuar nga KQZ-ja. Në bazë të atij plani, Sekretariati, me një personel të përhershëm prej 70 zyrtarëve dhe rreth 600 punëtorëve në baza të përkohshme dhe të rekrutuar për aktivitete të caktuara (*shih Shtojcën nr. 3 Struktura Organizative/organogrami i SKQZ-së*), ka kryer aktivitetet zgjedhore si në vijim:

1. **Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre**
2. **Shërbimi i Votuesve**
3. **Operacionet në Terren**
4. **Informimi i votuesve**
5. **Rekrutimi i zyrtarëve të përkohshëm në SKQZ**
6. **Trajnimi i Këshillave të Vendvotimeve**
7. **Qendra e Numërimit dhe Rezultateve**

**1. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike (Zyra)** - është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit të partive politike, certifikimin e të gjitha subjekteve politike që do të përfshihen në fletëvotim, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe deklaratave vjetore financiare.

- Në Regjistrin e Partive Politike janë të regjistruara dyzet e tri (43) parti politike. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë regjistruar katër (4) parti politike, janë çregjistruar nga Regjistri gjashtë (6) parti politike dhe janë pezulluar dy (2) parti politike. Nga partitë politike të regjistruara, tri (3) prej tyre nuk kanë marrur pjesë në zgjedhjet lokale të 15 nëntorit 2009 : “Partia Nacionale Demokratike Shqiptare”; “Nova Demokratija” dhe “Partija Demokratske Integracije”
- Zyra ka monitoruar tetë (8) Kuvende të partive politike, pesë (5) kanë qenë Kuvende të rregullta zgjedhore, ndërsa tri (3) kuvende të jashtëzakonshme

- Gjithashtu Zyra ka organizuar pesë (5) Forume me Subjektet Politike dhe Shoqërinë Civile
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me rekomandim të Zyrës ka certifikuar shtatëdhjetë e katër (74) subjekte politike për zgjedhjet lokale 2009
- Pas përfundimit të certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre Zyra ka organizuar dhe mbajtur tërheqjen e shortit të renditjes të subjekteve në fletvotim.
- Akreditimi i Vëzhguesve të Zgjedhjeve - Komisioni Qendror me rekomandim të Zyrës ka akredituar këtë numër të vëzhguesve: Vëzhguesit e akredituar për raundin e parë të zgjedhjeve më 15 nëntor: 22098, Vëzhguesit e akredituar për raundin e II-të më 13 dhjetor: 1405 (*shih Shtojcën nr. 4 Regjistri i Partive Politike*)

**2. Shërbimi i Votuesve** - funksionon në kuadër të Sekretariatit të KQZ-së. Aktiviteti kryesor i tij është informimi dhe edukimi i votuesve si dhe përpilimi i listës përfundimtare të votuesve.

- **Projekti “Përtrij adresën, voto aty ku jeton”**

Ky projekt ka synuar informimin dhe nxitjen e të gjithë votuesve potencial që kanë ndërruar adresat e banimit pas regjistrimit të tyre civil, e të cilat nuk i kanë përtërirë në zyret komunale të regjistrimit civil, që të lajmërojnë adresat e sakta të vendit ku jetojnë aktualisht, pranë zyreve komunale të regjistrimit civil. Ripërtirjen e adresave e bën të domosdoshë m edhe krijimi i komunave të reja dhe ndarja e re territoriale e komunave.

- Informimin dhe vetëdijësimin e votuesit që nëse nuk i lajmërojnë adresat e tyre të reja pranë zyrave komunale të regjistrimit civil, ata nuk mund të gjejnë vetën dhe të votojnë aty ku ata dëshirojnë.

- Ripërtirja e adresave do të përmirësojë dukshëm listën e votuesve;

- Do të zvogëlojë apo eliminojë votat me kusht;

- Do të shpërndajë saktë votuesit nëpër qendrat e votimit;

- Do të eliminohet hutia e votuesve në ditën e zgjedhjeve lidhur me qendren e votimit.

- **Projekti “Edukimi dhe informimi i votuesve të rinj”**

Ky projekt ka pasur për qëllim informimin dhe edukimin, përkatsisht vetëdijësimin e të rinjëve Kosovarë të cilët i kanë mbushur 18 vjet, ose deri në zgjedhjet e 15 Nëntorit 2009 do t'i mbushin 18 vjet, për rolin që mund të luajnë në përmirësimin e jetës, duke marrë pjesë aktive në procesin zgjedhor. Përkatsisht informimin e votuesve të rinjë për të drejtën e tyre për të votuar, procesin zgjedhor, sistemin dhe procedurat zgjedhore, si dhe për ndikimin që mund të ketë vota e tyre në zhvillimet e përgjithshme shoqërore. Në këtë drejtim janë organizuar ligjërata dhe debate nëpër të gjitha shkollat e mesme të Republikës së Kosovës, si dhe janë shpërndarë materiale informuese si: fletpalosje, postera dhe broshura.

- **Projekti “Votuesit e Verbër”**

Lidhur me projektin për Votuesit e Verbër dhe obligimin kushtetues që kësaj kategorie të shoqrisë, që t’ju mundësohet të votojnë personalisht dhe në mënyrë të pavarur, Njësia e Shërbimit Votues dhe Shoqata e të verbërve dhe me të pamë të dobësuar e Kosovës, për Zgjedhjet Lokale të 15 Nëntorit 2009 ka bërë shtypjen e 746 shablloëve për Kuvende Komunale dhe 746 shablloëve për Kryetar të Komunave, të cilat janë shpërndarë për Qendra të Votimit (gjithsejt 746 Qendra të Votimit).

Gjithashtu është bërë shtypja e Informatorëve në alfabetin e Braj-it (Listat e kandidatëve) për çdo vendvotim.

Në raundin e II-të gjithashtu është bërë shtypja e shablloneve për Fletëvotim për Kryetar Komune për 21 Komuna të Republikës së Kosovës, gjegjësisht 504 Shabllone për 504 Qendra të Votimit, në të gjitha ato komuna ku është mbajtur Raundi i II-të i Zgjedhjeve.

- **Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta**

Njësia e Shërbimit të Votuesve përmes Zyrtarëve Ekzekutiv Komunal ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura që votuesit e ngujuar në shtëpi, votuesit në institucione dhe ata me rrethana të veçanta të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar. Poashtu është bërë regjistrimi dhe identifikimi i votuesve nga këto tri kategori. Në të njëjtën kohë janë caktuar ekipet mobile të cilët i kanë shërbyer këtyre votuesve në ditën e zgjedhjeve në përputhje me procedurën e votimit për personat me nevoja të veçanta.

Për Votuesit e Ngujuar në Shtëpi, numri i përgjithshëm ka qenë: 1.541 votues, për votuesit në Institucione, numri i përgjithshëm i votuesve ka qenë: 4889 votues dhe numri i votuesve me rrethana të veçanta ka qenë 1.254.

Për të tri kategoritë numri i përgjithshëm i votuesve në Operacionin e votimit me nevoja të veçanta është: 7.684 votues.

Numri i Ekipeve Lëvizëse (Mobile) në të gjitha komunat që i kanë shërbyer kësaj kategorie të votuesve ka qenë gjithsej 110.

- **Votimi jashtë Kosovës**

Programi i votimit me Postë është ndërmarrë në mes 7 Gushtit 2009 dhe 6 Shtatorit 2009, periudhë kjo e zgjatur deri më 15 Shtator 2009. Përafërsisht 10.000 aplikacione i janë dërguar votuesve për votim përmes postës në bazë të të dhënave të vitit 2007. 24.400 forma tjera për aplikim i janë dërguar pikave të shpërndarjes në vendet tjera (përfshirë edhe Ambasadat e Republikës së Kosovës në botë). Deri në skadimin të afatit gjithsej 2.630 aplikacione janë pranuar, prej të cilave 1.806 janë miratuar dhe 824 janë refuzuar kryesisht për shkak të dhënave jo të plota dhe dokumenteve të pavlefshme të identifikimit. Janë pranuar aplikacione nga 26 vende të botës.

Operacioni i votimit përmes postës është zhvilluar përgjatë dy fazave: Faza e regjistrimit të votuesve që jetojnë jashtë Kosovës dhe faza e dërgimit të fletëvotimeve, përkatësisht e votimit.

Për Zgjedhjet për Kuvende Komunale dhe Kryetar Komune, në Raundin e I-rë ka pasur një numër prej gjithsej 1.368 Pliko të votueseve me fletëvotime.

1.306 Pliko votimi janë vlerësuar si valide në kategorinë – Aprovuar. 63 Pliko votimi janë Refuzuar.

Në Raundin e II-të janë pranuar gjithsej 132 pliko të votimeve, ku të gjitha janë vlerësuar si të miratuara.

- **Periudha e Shërbimit të Votuesve**

Të gjithë votuesit kanë pasë mundësi të kontaktojnë zyrën për shërbimin e votuesve gjatë periudhës së shërbimit të votuesve (nga 01/09/09 deri më 15/09/2009) për t'u informuar se në cilën qendër votuese janë ri-caktuar ose të kërkojnë ri-caktim të qendrës së votimit i cili është më i përshtatshëm për ta. Gjatë kësaj periudhe 4.538 votues kanë vizituar zyrat e KKZ-ve, 1550 votues kanë kërkuar **ndërrim të Qendrës së Votimit**. Prej këtyre kërkesave, 91 janë refuzuar; 60 votues janë refuzuar për arsye se Qendra Votuese në të cilën ata kanë kërkuar të

votojnë nuk ka qënë brenda kufijve të komunës ku ata jetojnë; 5 votues janë refuzuar për arsye se nuk kanë sjellë asnjë dokument identifikimi me vete dhe 26 votues kanë aplikuar më shumë se një herë për ndërrime dhe janë konsideruar si aplikues të dyfishtë. Për më tepër, qasja e konfirmimit të lokacionit në formë elektronike ende është e publikuar.

- **Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit të Listës Votuese**

Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit (nga 22/09/09 deri më 02/10/2009) i ka mundësuar të gjithë votuesve në Kosovë si dhe atyre të regjistruar me operacionin përmes postës që të sfidojnë LPV-në. Gjatë kësaj periudhe, 345 votues kanë konfirmuar të dhënat e tyre dhe 21 kanë sfiduar LPV-në. Pas periudhës së Kundërshtimit dhe Konfirmimit, zyra e Shërbimit të Votuesve ka marrë 16 vendime të gjykatave Komunale, 5 prej këtyre kanë qënë kërkesa për largimin e personave të vdekur dhe që figurojnë në LPV, 8 kanë qënë vendime për ri-caktim të Qendrave të Votimit dhe 3 vendime nuk janë aplikuar pasi që votuesit tashmë nuk ishin të përfshirë në listën e votuesve

- **Certifikimi i Listës Përfundimare të Votuesve (LPV)**

Lista Përfundimtare e Votuesve 2009 (**LPV 2009**) për Zgjedhjet Komunale dhe për Kryetarë të Komunave 2009 është bazuar në ekstraktin e Regjistrit Civil. Ky ekstrakt është përpiluar nga Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve (DPD), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës.

LPV-ja për zgjedhjet e 15 nëntorit 2009 përmban 1.563.741 emra të votuesve të ndarë në 36 Komuna, 746 Qendra të Votimit dhe 2256 Vendvotime.

Si shtesë LPV-ja përmban emrat e të gjithë votuesve me zotësi juridike të cilët kanë aplikuar me sukses në programin e votimit jashtë Kosovës.

Numri i Përgjithshëm i Votuesve në LPV 2009 është **1. 563 741** votues. Bazuar në të dhënat nga Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve pranë MPB-së , Zyra për Shërbim të Votuesve ka larguar **22.851** votues të vdekur nga LPV-ja, **3.000** të cilët nuk kanë marrë kurrfarë dokumenti të regjistrimit (nga UNMIK-u apo R. e Kosovës) si dhe ka larguar 7 votues të regjistruar dy herë.

### **3. Operacionet në Terren**

- **Emërimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe Këshillave të Vendvotimeve (KVV)**

- KQZ-ja me datën 06.07.2009 ka emëruar Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) për zgjedhjet komunale të 15 nëntorit 2009 për tridhjetë e një (31) komuna të Republikës së Kosovës. Në zgjedhjet e 15 nëntorit dhe Raundin e II-të të zgjedhjeve në tri komuna janë angazhuar gjithsej 214 anëtarë të KKZ-ve në bazë të nominimeve nga subjektet politike.
- KQZ-ja me datën 21.10.2009 ka emëruar Këshillat e Vendvotimeve (KVV) për zgjedhjet komunale të 15 nëntorit 2009 për tridhjetë e gjashtë (36) Komuna të Republikës së Kosovës. Në zgjedhjet e 15 nëntorit dhe Raundin e II-të të zgjedhjeve në tri komuna janë angazhuar gjithsej 40.995 anëtarë të KVV-ve.
- KQZ-ja ka miratuar gjithsej 746 Qendrat të Votimit dhe 2.256 Vendvotime për Zgjedhjet Lokale të 15 nëntorit 2009.

Të dhëna: Gjithsej 746 QV. QV të reja 125. Gjithsej Vendvotime 2.256, prej tyre 9 VV të reja. Rritja e Vendvotimeve nuk është bërë në proporcion me QV-të për arsye se numri i votuesve për një VV nga 750 votues me vendim të KQZ-së është rritur deri në 950 votues për një VV. Numri i Votuesve të ri në krahasim me zgjedhjet e vitit 2007 është rritur për 118.878 votues. KQZ-ja me 05.11.2009 ka miratuar 73 Qendra alternative të Votimit për zgjedhjet komunale të 15 nëntorit 2009.

#### **- Plani Operacional i Sigurisë për Ditën e Zgjedhjeve**

Me 24.08.2009 KQZ-ja ka miratuar Planin Operacional të Sigurisë për zgjedhjet lokale të 15 nëntorit 2009. Qëllimi i Planit është krijimi i kushteve për mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike për Kuvendet Komunale dhe për Kryetarë të Komunav në mbarë Kosovën në një atmosferë të qetë, pa detyrime, frikësime ose lëndime të asnjë qytetari të Republikës së Kosovës.

*Për më tepër Plani Operacional i Sigurisë parasheh:*

- Në nivelin rajonal, struktura për planifikim operativ/siguri do të menaxhohet nga KQZ-ja në bashkëpunim me Policinë e Kosovës;
- SKQZ-ja në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës të përkrahur edhe nga EULEX dhe KFOR
- Nën percjelljen e vazhdueshme të PK-së i gjithë materiali sensitiv është siguruar në çdo kohë, duke përfshirë këtu transportin e materialit sensitiv që ka hyrë në Republikën e Kosovës në pikat kufitare;
- Bashkëpunimi i ngushtë në mes SKQZ-PK-Doganat e Republikës së Kosovës, ka qënë në nivelin më të lartë;
- Për Ditën e Zgjedhjeve, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka formuar Njësinë e Monitorimit, e cila ka qënë përgjegjëse për:
  - Mbajtjen e ndërlidhjes së ngushtë me Policinë e Kosovës;
  - Mbajtjen e kontakteve të ngushta me personelin e KKZ-ve;
  - Marrjen e të gjitha raporteve mbi incidentet që arrijnë nga PK-ja dhe ZLKZ-të dhe të mbajtura nga Koordinatorin i ZLKZ-ve në SKQZ-së të informuar rregullisht për situatën ekzistuese.
  - Monitorimin e transportimit dhe kthimit të fletëvotimeve nga depot kryesore në QV-të dhe kthimin e tyre prapa në QNR.

#### **4. Informimi i Votuesve**

##### **- Strategjia e Informimit Publik për zgjedhjet lokale të 15 nëntorit 2009**

Strategjia e Informimit Publik për zgjedhjet lokale të 15 nëntorit 2009 ka përcaktuar objektivat si në vijim:

- Dhënia e informatave për procesin zgjedhor votuesve dhe partive politike;
- Inkurajimi i pjesëmarrjes në zgjedhje;
- Informimi i votuesve mbi të drejtat e tyre për votim;
- Informimi për rendësinë e votës së tij/saj;
- Informimi për mënyrën e votimit;
- Informimi mbi vendvotimin dhe ditën (kohën) e votimit.
- Miratimi i Projektit për Qendren Mediale

## **- Mbikqyrja e Informimit Publik**

Fushata e Informimit Publik është menaxhuar përmes Këshillit Mbikëqyrës të Fushatës së Informimit Publik i cili i ka raportuar drejtpërdrejt KQZ-së. Këshilli Mbikëqyrës është përbërë nga anëtarë të KQZ-së dhe menaxhmenti i Sekretariatit të KQZ-së.

### **5. Rekrutimi i zyrtarëve të përkohshëm të Sekretariatit të KQZ-së**

Në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil nr. 2001/36 dhe UA 2003/01 mbi Procedurat e Rekrutimit, Sekretariati i KQZ-së ka shpallur konkurset për pranimin e zyrtarëve me punë të përkohshme me kohë të plotë pune. Prej tyre 156 zyrtarë të përkohshëm, 214 anëtarë të Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe 194 Trajnerë në Komuna. Ndërkaq prej zyrtarëve të përkohshëm me kohë jo të plotë 490 zyrtarë në Qendren e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) dhe 35.839 anëtarë të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) për të dy raundet e zgjedhjeve. Konkursi për pranimin e stafit të përkohshëm të sipërpermendur në SKQZ është ndarë në tri faza

### **6. Trajnimi i Këshillave të Vendvotimeve (KVV)**

Për trajnimin e anëtarëve të KVV-ve për zgjedhjet komunale dhe Raundin e II-të për Kryetarë të Komunave janë angazhuar gjithsej 200 trajnerë të përzgjedhur përmes procedurave të rregullta të rekrutimit-me konkurs.

### **7. Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)**

#### **- Miratimi i Procedurave të QNR-së**

Procedurat e QNR-së janë udhëzimet që sigurojnë realizimin e duhur të detyrave të caktuara të personelit të Qendrës së Numërimit dhe të Rezultateve. Në udhëzime përsëritet organizimi i përgjithshëm i QNR-së dhe rrjedha e materialit të ndjeshëm të zgjedhjeve nga pranimi e deri te arkivi, si dhe detyrat që kryhen hap pas hapi në secilën hapësirë brenda QNR-së .

## **III. Shpallja dhe Certifikimi i rezultateve të Zgjedhjeve Lokale 2009**

- *Shpallja e rezultateve paraprake (preliminare) të zgjedhjeve*

Në bazë të rezultateve të pranuar nga Kryesuesit e Këshillave të Vendvotimit, KQZ-ja ka shpallur rezultatet preleminare për Zgjedhjet Komunale, zgjedhjet për Kryetar të Komunave si dhe Zgjedhjet e Raundit të II-të për Kryetar të Komunave.

- *Shpallja e rezultateve nga QNR-ja*

Në bazë të rezultateve të përpiluara nga QNR-ja, duke përfshirë fletëvotimet përmes postës, fletëvotimet e votimit me kusht, fletëvotimet e personave me nevoja dhe rrethana të veçanta, si dhe pas zgjidhjes së ankesave që kanë të bëjnë me procesin e votimit dhe numërimit në Vendvotim/e, KQZ-ja ka shpallur rezultatet e zgjedhjeve nga QNR-ja për të gjitha nivelet e zgjedhjeve.



- *Certifikimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve*

KQZ-ja ka certifikuar rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale, për Kryetar të Komunave si dhe Raundit të II-të të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave pasi kanë përfunduar të gjitha procedurat në vendvotime dhe në qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha vërejtjet që u përkasin votimit dhe numërimit në vendvotim janë vendosur nga Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP) dhe nga Gjykata Kushtetuese.

Me datën 04.12.2009 KQZ-ja ka certifikuar rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit 2009 për Kryetar të Komunave.

Me datën 14.12.2009 KQZ-ja ka certifikuar rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit 2009 për 36 Kuvendet Komunale.

- *Shpallja e rezultateve përfundimtare të Raundit të II-të të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave*

Në pajtim me vendimin e KQZ-së të datës 04.12.2009 është organizuar Raundi i II-të i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave në njëzet e një (21) Komuna të Republikës së Kosovës me 13 dhjetor 2009.

Në këto zgjedhje është zbatuar Rregulla Zgjedhore e KQZ-së nr. 10/2009 “Raundi i II-të i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave”, të gjitha dispozitat e ndërlidhura të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Zgjedhjet Lokale si dhe Rregullat tjera Zgjedhore të KQZ-së.

Me datën 29.12.2009 janë certifikuar rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve të Raundit të II-të për Kryetar të tetëmbëdhjetë (18) Komunave të Republikës së Kosovës. (*shih shtojcën nr. 6 Pasqyra përmbledhëse të aktiviteteve zgjedhore 2009*)

#### **IV. Buxheti i KQZ-së për vitin 2009**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK).

Për vitin zgjedhor 2009 Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i është ndarë buxheti në shumën prej 8.320.775 € i detajuar sipas klasifikimit buxhetor si vijon:

a. Pagat dhe mëditjet	246,647 €
b. Shpenzime për Mallra dhe Shërbime	7.880,773 €
c. Shpenzime komunale	28.740 €
d. Shpenzime kapitale	164.615 €
<b>Totali:</b>	<b>8.320.775 €</b>

Struktura buxhetore përbëhet prej; 3.0 % të fondeve që janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje, 94.7 % të fondeve të akorduara për shpenzime, mallra dhe shërbime, 0.3% për shpenzime komunale dhe 2 % për shpenzime kapitale.

Me Rishikimin e buxhetit, KQZ-së i janë lejuar mjete buxhetore shtesë për vitin 2009 në shumën prej 79.225,00 € për paga dhe meditje.

Tabela nr. 2: Struktura e Buxhetit 2009

Raporti i Buxhetit	Buxheti i Aprovuar Fillestar	Buxheti i Aprovuar me Ndryshime	Buxheti i Shpenzuar	Përqindja (%)
2009				
Buxheti Total 2009	8,320,775	8,400,434	5,217,236	62%
Pagat dhe Mëditjet	246,647	414,506	366,952	88.5%
Mallra dhe Shërbime	7,880,773	7,792,573	4,719,600	60.6%
Shpenzime komunale	28,740	28,740	22,739	79%
Shpenzime Kapitale	164,615	164,615	107,945	65.6%

Mjetet e buxhetit zgjedhor të KQZ-së janë shfrytëzuar sipas zërave të shpenzimeve.

Zbatimi i procedurave të tenderëve të hapur si dhe formave tjera tenderuese duke iu shmangur përdorimit të procedurave të prokurimit njëburimor, është arritur plotësimi i nevojave.

Realizimi i buxhetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2009 paraqitet si vijon:

a. Pagat dhe mëditjet	366.952 €
b. Mallra dhe Shërbime	4.719,600 €
c. Shpenzime komunale	22.739 €
d. Shpenzime kapitale	107.945 €
<b>Totali:</b>	<b>5.217,236 €</b>

Realizimi i buxhetit për vitin 2009 kundrejt planit është bërë në masën 62 %, kështuqë nga 8.4 milion Euro të buxhetit të lejuarj anë realizuar vetëm 5.2 milion Euro. Mjetet e pashfrytëzuara në shumën prej 3.2 milion Euro janë kryesisht nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Raundi i II-të i zgjedhjeve është mbajtur në fund të vitit 2009, kështuqë nuk ka qënë e mundur të kryhen të gjitha pagesat dhe obligimet brenda këtij viti dhe këto obligime janë bartë në ngarkesë të buxhetit të vitit 2010.

Donacionet e dhëna si nga IFES, ECMI dhe ai i Zyrës Gjermane kanë ndikuar në kursimin dhe shkallën e shfrytëzimit të mjeteve të ndara nga Buxheti.

Për krijimin e “Qendrës mediale” të KQZ-së nga Republika Federale e Gjermanisë e përfaqësuar nga Ministri Federal për Punë të Jashtme, KQZ-ja ka pranuar donacionin në vlerë prej 40,510€ i cili është realizuar 100%.

Logjistika i ka kryer me efikasitet obligimet të cilat kanë ndikuar pozitivisht në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Furnizimi dhe shpërndarja e materialit zgjedhor josensitiv në vendvotime është realizuar në përputhje me planin e ekspeditimit. Me kohë për të dy raundet e zgjedhjeve janë siguruar materialet e nevojshme zgjedhore është përgatitur lista totale e resurseve për materialet zgjedhore për të dy raundet e zgjedhjeve.

Shpërndarja e materialit sensitiv (fletëvotimet, vulat etj) është bërë nga Sekretariati i KQZ-së me përcjelljen e forcave të Policisë së Kosovës.

Materiali zgjedhor sensitiv dhe josensitiv është shpërndarë të gjitha vendvotimet në Kosovë sipas dinamikës së planifikuar. *(shih shtojcën nr. 5 Pasqyrat Financiar të KQZ-së për vitin 2009)*

## **V. Bashkëpunimi i KQZ – së me institucionet tjera në vend**

Në funksion të bashkëpunimit rreth organizimit dhe mbarëvajtjes së zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit 2009, KQZ-ja ka lidhur Marrëveshje Mirëkuptimi me: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Ministrinë për Kthim dhe Komunitete (MKK), Universitetin e Prishtinës (UP) dhe Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK).

- MiM me MAPL-në parasheh ofrimin e kushteve të nevojshme për punën e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ), duke përfshirë edhe sigurimin e zyrave brenda ndërtesave të administratës komunale;
- MiM me MASHT-në parasheh bashkëpunimin reciprok përkatësisht shfrytëzimin e objekteve shkollore si Qendra të Votimeve (QV), sallave të edukatës fizike për ditën e zgjedhjeve për pranimin e materialit zgjedhor si dhe objekte shkollore për organizimin e trajnimeve të KVV-ve;
- MiM me MPB-në parasheh ofrimin e mbështetjes teknike të MPB-së në krijimin e Listës Votuese përmes të dhënave nga Regjistri Civil i Kosovës dhe në ofrimin e ndihmave tjera profesionale dhe teknike sipas kërkesave të KQZ-së;
- MiM me MKK-në parasheh ofrimin e të dhënave KQZ-së për numrin e të zhvendosurve, vendndodhjen e tyre dhe numrin e të kthyerve, identifikimin e partnerëve kontraktues për bashkëpunim si OJQ-të dhe partnerët tjerë si dhe ndihmë tjetër sipas kërkesës së KQZ-së;
- MiM me UP-në parasheh bashkëpunimin lidhur me shfrytëzimin e Sallës Solemne të Fakultetit Filologjik të UP-së për Qendër Mediale të KQZ-së gjatë procesit zgjedhor 2009;

- MiM me KEK-un parasheh bashkë punimin në furnizimin e pandërprerë me energji elektrike gjatë procesit zgjedhor 2009 të Qendres së Numërimit dhe Rezultateve (QNR) dhe të gjitha Qendrave të Votimit (QV) dhe Vendvotimeve (VV) gjatë periudhës prej 10.11.2009 deri më 31.12.2009.

## **VI. Bashkëpunimi i KQZ-së me institucionet ndërkombëtare**

### **- Bashkëpunimi me OSBE-në**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bashkëpunim të ngushtë me Misionin e OSBE-së në Kosovë është pajtuar që t'i ofrohet përkrahje, këshilla dhe trajnime për KQZ-në dhe Sekretariatit në sferat e mëposhtme:

- Planifikimin dhe implementimin e zgjedhjeve lokale 2009 – një personeli prej 22 ekspertesh ndërkombëtar dhe vendor (6 prej tyre kanë vepruar në nivel regjional). Personelit të DZ/OSBE i është ofruar akomodim nga KQZ-ja në të njëjtën ndërtesë me KQZ/SKQZ-në për të lehtësuar bashkëpunimin dhe përkrahjen midis këtyre dy palëve. Ky staf profesional ka përkrahur dhe këshilluar në vazhdimësi KQZ-në në çështjet menaxhuese zgjedhore dhe ka përkrahur punën e Sekretariatit në aspektin teknik gjatë gjithë ciklit zgjedhor.
- Një numër tjetër i personelit të OSBE-së (85 zyrtarë ndërkombëtar dhe vendor të rekrutuar përkohësisht) kanë ofruar përkrahje dhe këshilla në projekte zgjedhore të caktuara si në vijim:
  1. Përpilimin e listës së votuesve
  2. Votimin përmes postës
  3. Certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve
  4. Logjistikë
  5. Komisionet Komunale të Zgjedhjeve
  6. Trajnimin e trajnerëve dhe Këshillave të Vendvotimeve
  7. Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

### **- Bashkëpunimi me IFES/Zyra në Kosovë**

KQZ-ja me 28 shtator 2009 ka nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me IFES/Zyra në Kosovë. Me këtë Marrëveshje IFES/Zyra në Kosovë i ofron KQZ-së mbështetje në ngritjen e efikasitetit në zbatimin e procesit zgjedhor, ndihmë profesionale, trajnime për anëtarët e KQZ-së si dhe zyrtarët e Sekretariatit të KQZ-së në kuadër të programit të USAID-it për "Ngritje profesionale të Administratës së Zgjedhjeve në Kosovë.

Në mënyrë të veçantë bashkëpunimi/ndihma e IFES/Zyra në Kosovë sipas kësaj Marrëveshjeje fokusohet në:

- Ofrimin e mbështetjes KQZ-së në zbatimin e procedurave të përgjithshme dhe çështjeve teknike të operacioneve të zgjedhjeve përfshirë aktivitetet e veçanta siç janë: Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, Fushata e Informimit Publik dhe Prezantimi Medial.
- Inicimin e prezantimit të programeve të veçanta siç janë: mbledhja, përpunimi dhe publikimi i rezultateve preleminare të zgjedhjeve.

## **- Bashkëpunimi me Ambasadën e Republikës Gjermane**

Ambasada e Republikës Gjermane në Kosovë e përfaqësuar përmes Ministrit Federal për Punë të Jashtme ka financuar projektin për Qendrën Mediale të KQZ-së gjatë periudhës intensive zgjedhore përkatësisht deri në certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit 2009.

## **- Bashkëpunimi me ECMI/Kosova**

KQZ-ja me datën 28.09.2009 ka miratuar Projektin e financuar nga ECMI/Kosova (Qendra Europiane për Çështje të Minoriteteve) “Edukimi i Votuesve në komunat e reja” për zgjedhjet lokale të 15 nëntorit 2009. Ky projekt ka synuar ofrimin e ndihmës KQZ-së në shpërndarjen e informacionit dhe përpilimin e informacionit shtesë komunitetit/grupit të synuar. Aktivitetet e ECMI/Kosova janë përqendruar në komunat e reja në jug të lumit Ibër, Graçanicë, Raillug, Kllokot/Vërboc dhe Novobërdë.

Aktivitetet e ECMI/Kosova kanë synuar kryesisht anëtarët e komunitetit serb dhe RAE të moshës së votimit që jetojnë në komunat përkatëse, përderisa komuniteti shqiptarë është informuar nëpërmjet fushatës së rregullt informuese.

*Aktivitetet e ECMI/Kosova:*

- Asistencë në shpërndarjen e materialeve zgjedhore të informimit publik të KQZ-së;
- Shpërndarja e materialeve të shtypura të ECMI/Kosova;
- Organizimi i takimeve publike me votuesit.

## **- Nënshkrimi i Marrëveshjes me ACEEEO**

Me datën 08.05.2009 KQZ-ja ka nënshkruar Marrëveshjen për Anëtarësim në Asociacionin e Zyrtarëve Zgjedhorë Europian-ACEEEO me seli në Budapest.

Përmes kësaj marrëveshjeje KQZ-ja përfiton asistencë në programet e trajnimeve mbi çështjet zgjedhore si dhe ngritjen e kapaciteteve teknike menaxhuese të zgjedhjeve.

*Ky raport mund të gjendet edhe në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ([www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org))*